



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 korrik 2023
Nr. ref.: RK 2236/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI11/23

Parashtrues

“SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [E. Rev. nr. 47/2022] të Gjykatës
Supreme të Kosovës të 1 shtatorit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kompania e Sigurimeve “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” me seli në Prishtinë e përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Saimir Dhamo.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [E.Rev.nr. 47/2022] të 1 shtatorit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës.
3. Aktgjykimi [E. Rev.nr. 47/2022] i 1 shtatorit 2022 i Gjykatës Supreme, i është dorëzuar të parashtruesit të kërkesës më 10 tetor 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [E. Rev. nr. 47/2022] të Gjykatës Supreme të 1 shtatorit 2022, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 (Procedimi i kërkesës) dhe nenin 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 20 janar 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 25 janar 2023, Kryetarja e Gjykatës, me vendimin [Nr.GJR.KI11/23], caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe me vendimin [Nr.KSH.KI11/23] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci, anëtarë.
8. Më 1 shkurt 2023, Gjykata : **(i)** njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të plotësojë dhe dorëzojë formularin e kërkesës, në mënyrë që Gjykata të procedojë tutje me kërkesën; **(ii)** i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe **(iii)** kërkoi nga Gjykata Komerciale në Prishtinë informacione shtesë lidhur me ditën kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E.Rev.nr.47/2022] të 1 shtatorit 2022.
9. Më 3 shkurt 2023, Gjykata pranoi një shkresë nga Gjykata Komerciale lidhur me kërkesën e Gjykatës.
10. Më 14 shkurt 2023, Gjykata pranoi formularin e kërkesës të plotësuar nga parashtruesi i kërkesës ashtu siç i ishte kërkuar.
11. Më 7 qershor 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme për shqyrtim.

Përmbledhja e fakteve të rastit

12. Nga shkresat e lëndës, Gjykata konstaton se esenca e procedurës gjyqësore në gjykatat e rregullta në rastin konkret ka të bëjë me një aksident të komunikacionit që kishte ndodhur më 20 prill 2009. Në atë aksident të komunikacionit, morën pjesë dy automjete, nga të cilat njëri automjet ishte i siguruar te parashtruesi i kërkesës dhe vetura tjetër i përkiste kompanisë N.T.P “Sharr Beton”. Nga raporti i Policisë [nr. 2009/GK/0384] i 20 prillit 2009, rezulton se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me fajin e ngasësit L. B., i cili duke drejtuar automjetin e tipit tip “Opel Kadet” i siguruar te parashtruesi i kërkesës, ka tejkalluar në mënyrë të paligjshme automjetin tjetër dhe ka shkaktuar aksidentin në komunikacion.
13. Meqenëse parashtruesi i kërkesës dhe kompania N.T.P “Sharr Beton” nuk u pajtuan në lidhje me versionin e ngjarjes, rreth përgjegjësisë për fajin, si dhe për pagesën e lartësisë së kompensimit për dëmin e shkaktuar automjeteve, erdhi deri te zhvillimi i procedurës gjyqësore, të cilin Gjykata do ta paraqesë në vazhdim të aktvendimit.
14. Më 17 gusht 2010, N.T.P “Sharr Beton” kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore Prishtinë”, duke kërkuar kompensim dëmi material në shumën prej 30,000 € me kamatë ligjore të llogaritur nga dita e shkaktimit të dëmit deri në pagesën definitive të detyrimit, kundër parashtruesit të kërkesës.
15. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës përmes përgjigjes në padi, e kishte kontestuar kërkesëpadinë si të pabazuar me arsyetimin se : “... raporti policor është përpiluar nga deklaratat e të dy drejtuesëve të automjeteve, pa i bërë matjet në vendin e ngjarjes në përshkrimin e detajuar të mënyrës së lëvizjes së automjeteve, shpejtësinë e lejuar, e në veçanti për shkruarjen e saktë të mënyrës së goditjes së automjeteve dhe pasojat e mundshme të goditjes...”, duke konkluduar se paditësi është vetëaksidentuar.
16. Më 13 qershor 2011, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Ekonomike e Qarkut) nëpërmjet Aktgjykimit [II.C.nr.313/2010], (i) e aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.T.P “Sharr Beton” dhe (ii) e detyroi parashtruesin e kërkesës si palë e paditur që t’ia kompensoi palës në fjalë shumën prej 13,395.00 € në emër të dëmit material dhe shumën prej 41,200.00 € në emër të fitimit të humbur, e që gjithsej përbënin shumën prej 54,595.00 € me kamatë vjetore, sipas normës 20% duke filluar nga data 20 prill 2009 e deri në pagesën definitive; si dhe (iii) t’ia kompensoi palës në fjalë edhe shpenzimet e procedurës kontesitmore në shumë prej 1,328 €.
17. Gjykata Ekonomike e Qarkut në Aktgjykimin [II.C.nr.313/2010] kishte arsyetuar se :

“ Pas shqyrtimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vërtetoi se e siguruar e të paditurit nga autopërgjegjësia (...) duke mos qenë e kujdesshme gjatë lëvizjes me automjet, duke ndërmarrë veprimin e tejkallimit pa u siguruar paraprakisht (...), këtë veprim e ka marrë në pjesën e rrugës ku me shenja horizontale dhe vertikale është i ndaluar tejkallimi, i shkaktoi dëm në automjetin transportues-mikeserin e paditësit (...) Mirëpo, meqenëse kjo si shkaktuese e dëmit e ka pasur sigurimin nga autopërgjegjësia të i padituri, gjykata konformë nenit 897 të LMD-së, e detyroi të paditurin që paditësit t’ia kompensoi dëmin e shkaktuar nga i siguruari i saj.”
18. Brenda afatit ligjor, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar ankesë në Gjykatën Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) kundër Aktgjykimit [II. C. nr.

313/2010] të Gjykatës Ekonomike të Qarkut për shkak të : **a)** shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; **b)** vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe **(c)** zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

19. Më 28 tetor 2013, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ae. nr. 497/2012] **(i)** e pranoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe **(ii)** e prishi në tërësi Aktgjykimin [II. C. nr. 313/2010] të Gjykatës Ekonomike të Qarkut 13 qershorit 2011 duke e kthyer të njëjtën në rigjykim tek shkalla e parë, me arsyetimin se : *“Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë, të paditurës nuk i ka dorëzuar ekspertizën e komunikacionit, që vërtetohet nga fletëdorëzimi i pranuar nga e paditura me datën 31.05.2010 (...) Gjykata e Apelit e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e këtillë e çështjes, ka gjetur se aktgjykimi i ankimuar është marrë në bazë të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 18.1 nën i) të LPK-së, ngase të paditurës iu është mohuar kundërligjshëm e drejta që të sqarohet lidhur me ekspertizën e komunikacionit”.*
20. Pas kthimit të çështjes në rigjykim nga Gjykata e Apelit tek Gjykata Themelore, parashtruesi i kërkesës kishte propozuar caktimin e një ekspertize tjetër të komunikacionit për të vërtetuar besueshmërinë e kërkesëpadisë. Kërkesa e parashtruesit të kërkesës është aprovuar nga Gjykata Themelore dhe ai kërkoi që të bëhet ekspertizë e sërishme për aksidentin e trafikut.
21. Më 9 janar 2016, tre ekspertë (N.I, G.H. dhe M.B.) me kërkesë të Gjykatës Themelore, kanë kryer përsëri ekspertizën për aksidentin e komunikacionit, dhe në Gjykatën Themelore kanë dorëzuar dy versione të mundshme lidhur me ngjarjen.
22. Sipas versionit të parë, raporti i ekspertit mbështetet tërësisht në raportin e policisë [nr. 2009/GK/0384] të 20 prillit 2009, ndërsa te versioni i dytë, ekspertët paraqesin mundësinë që aksidenti i komunikacionit të ketë ndodhur për shkak të shpejtësisë së së lëvizjes të papërshtatshme ndaj kushteve të rrugës së mjetit transportues që i përkiste kompanisë NTP “Sharr Beton”.
23. Më 18 nëntor 2016, Gjykata Themelore mori Aktgjykimin [C.nr.636/2013] me të cilin **(i)** e refuzoi në tërësi kërkesëpadinë e paditësit N.T.P “Sharr Beton” dhe **(ii)** e detyroi paditësin N.T.P “Sharr Beton” që t’ia paguaj parashtruesit të kërkesës si palë e paditur shumën prej 489.00 € në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore.
24. Në arsyetimin e Aktgjykimit [C. nr. 636/2013], Gjykata Themelore ndër të tjera theksoi se :

“Gjykata me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së palës paditëse është bazuar paraprakisht në variantin e dytë të përshkruar si dhe në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të dhënë në ekspertizën e hartuar me datën 09.01.2016, po ashtu gjykata ka analizuar dhe i ka vlerësuar edhe provat tjera (...) ekspertizat tjera të hartuar me shkrim nga ekspertët financiar Sh.M dhe A.G, nga eksperti i komunikacionit A.A dhe eksperti i makinerisë N.Sh, po ashtu nga raporti i policisë, deklarata e të pandehurës si dhe nga aktvendimi i Gjykatës për Kundërvajtje...”.

[...]

“Ndërsa lidhur me propozimet e palëve gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore gjykata ka kërkuar nga palët ndërgjyqëse nëse kanë prova tjera shtesë apo propozime eventuale përveç atyre që gjenden në shkresat e lëndës, mirëpo të njëjtit nuk kanë paraqitur prova të tjera shtesë dhe nuk kanë bërë

propozime tjera andaj gjykata bazuar në shkresat e lëndës duke iu referuar dispozitave të nenit 319 paragrafi 1 dhe nenin 222 të LPK-së ka vendosur në mënyrë meritore...”

25. Brenda afatit ligjor, paditësi N.T.P “Sharr Beton” kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të: **a)** shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; **b)** konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit : **(i)** të prishtë Aktgjykimin e atakuar dhe **(ii)** ta kthej çështjen në rigjykim në shkallën e parë.
26. Më 9 korrik 2019, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktvendimit [Ae. nr. 8/2017], **(i)** aprovoi si të bazuar ankesën e paditësit N.T.P “Sharr Beton” dhe **(ii)** prishi Aktgjykimin [C. nr. 636/13] të Gjykatës Themelore të 18 nëntorit 2016 duke ia kthyer të njëjtës gjykatë çështjen në rigjykim dhe rivendosje.
27. Lidhur me shkeljet thelbësore me të cilat Gjykata e Apelit kishte konstatuar se është marrë aktgjykimi i goditur me ankesë, në arsyetimin e Aktvendimit [Ae. nr. 8/2017] kishte konkluduar se:

“Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par.2 pika n), për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës.”

“Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, po rrë në mënyrë të njëanshme duke ia falur besimin vetëm mendimit dhe konstatimit të ekspertëve të komunikacionit dhe atë duke e pranuar njërën version të dhënë nga ekspertët si mundësi por pa e argumentuar, ka marrë vendimin e atakuar.”

“Aktgjykimi i atakuar në arsyetimin e tij nuk thekson fare se nga cilat prova cilat fakte janë vërtetuar, por gjykata si prova ka administruar vetëm supër ekspertizën mbi aksidentin e komunikacionit të datës 09.01.2016 të komisionit të ekspertëve, pa i vlerësuar edhe provat e tjera të kësaj çështje kontestimore dhe pa dhënë arsye se pse gjykata nuk ia falë besimin provave tjera. (...)”

28. Më 21 maj 2021, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin [V.EK. nr. 211/21] me të cilin vendosi si në vijim : **(i)** refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit N.T.P “Sharr Beton” dhe **(ii)** detyroi që t’ia paguajë shumën prej 489 € parashtruesit të kërkesës si e paditur.
29. Sa më sipër, Gjykata Themelore kishte sqaruar se lidhur me këtë çështje, në ekspertizën e datës 9 janar 2016 ishin paraparë dy versione se si kishte ndodhur aksidenti si në vijim : *“varianti i parë i cili është bazuar në raportin policor dhe nga i cili variant rezulton se deri te ngjarja-aksidenti ka ardhur si rezultat i lëshimit të automjetit “Opell Kadet”, të siguruar te e paditura, ndërsa sipas variantit të dytë deri te ndodhja e aksidentit ka ardhur si rezultat i humbjes së kontrollit të automjetit transportues “Magirus” në kthesë, gjegjësisht nga mospërshtatja e shpejtësisë së lëvizjes, kushteve të rrugës në kthesë nga ana e ngasësit të këtij automjeti. Grupi i*

ekspertëve në mendimin e tyre përfundimtar kanë konstatuar se besueshmëria më e madhe është rrjedha e aksidentit të jetë zhvilluar sipas variantit të dytë.”

30. Në këtë drejtim, Gjykata Themelore Aktgjykimin [V.EK. nr. 211/21] e arsyetoi me konstatimin se : *“Gjykata pasi analizoi provat e administruara, në kuptim të nenit të LPK-së, dhe deponimet e palëve ndërgjyqëse, vlerësoi se kërkesëpapia e paditësit është e pabazuar dhe atë në bazë të gjendjes faktike, gjykata vërtetoi se deri te aksidenti i ndodhur më datë 20.04.2009, ka ardhur si rezultat të drejtuesit të automjetit kamion “Magirus”, pronë e këtu palës paditëse, kështu duke ia falur besimin në tërësi variantit të dytë të dhënë në ekspertizën e hartuar nga grupi i ekspertëve”,*
31. Brenda afatit ligjor, paditësi N.T.P “Sharr Beton” parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [V.EK.nr.211/21] për shkak të : **a)** shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore; **b)** të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe **c)** të zbatimi të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që: **(i)** aktgjykimi i atakuar të priset dhe **(ii)** çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.
32. Më 9 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur përgjigje në ankesë, duke kërkuar që: **(i)** të refuzohet në tërësi si ligjërishit dhe faktikisht e pathemeltë ankesa e paditësit N.T.P “Sharr Beton” kundër Aktgjykimit [V.EK. nr. 211/21] të Gjykatës Themelore dhe **(ii)** të vërtetohet i njëjti aktgjykim si ligjërishit dhe faktikisht i themeltë, me arsyetimin se : *“Nuk qëndrojnë pretendimet e palës paditëse në ankesë, për shkelje esenciale , vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkelje materiale, sepse Gjykata me rastin e vendosjes, mirë dhe drejtë ka shtjelluar dhe vlerësuar të gjitha provat, konkretisht super ekspertizën e Fakultetit Teknik dhe sqarimin e ekspertit G.Z* në seancën kryesore, pasi që eksperti në mënyrë të detajuar, ka konstatuar se në rastin konkret, kam analizuar dy variante (...) dhe fakulteti është përcaktuar për variantin e dytë...”*
33. Më 14 dhjetor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ae.nr.190/21] vendosi që: **(i)** të aprovohet si pjesërisht të themeltë ankesën e paditësit N.T.P “Sharr Beton”; **(ii)** të ndryshohet Aktgjykimi [V.EK. nr. 211/21] i Gjykatës Themelore të 21 majit 2021; dhe **(iii)** të detyrohet parashtruesi i kërkesës si palë e paditur që në emër të kompensimit të dëmit material-real t’ia kompensoj paditësit N.T.P “Sharr Beton” shumën prej 13,395.00 € si dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 4,500.00 € apo shumën e përgjithshme prej 17,895.00 €, e të gjitha këto me kamatë në lartësi vjetore sipas mjeteve të deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga data 17 gusht 2010 e deri në pagesën definitive; **(iv)** shpenzimet e procedurës secila t’i bart vet.
34. Gjykata e Apelit nuk ishte pajtuar me qëndrimin juridik dhe përfundimin e Gjykatës Themelore, andaj në arsyetimin e saj kishte theksuar se :

“Gjykata e shkallës së parë gjatë vendimmarrjes nuk i ka vlerësuar me kujdesin e duhur provat e lartcekura një nga një dhe të gjitha së bashku ashtu siç parashihet me nenin 8 të LPK-së, me rastin e vlerësimit të ekspertizës së komunikacionit të punuar nga grupi i ekspertëve dhe si rezultat ka ardhur në përfundim të gabuar se duhet t’ia fal besimin variantit II të ekspertizës së komunikacionit i cili mendim nuk është bazuar në provat e siguruara menjëherë pas ndodhjes së rastit (...) por grupi i ekspertëve mendimin e tyre e bazojnë ekskluzivisht në supozime, ku edhe vet ekspertët në faqen 8 të ekspertizës e konstatojnë një gjë të tillë, ndërsa gjykata e shkallës së parë nuk je parye për mos faljen e besimit provave tjera materiale, si dhe mendimit të grupit të ekspertëve të shprehur si në variantin I, të cilët kanë

konstatuar se aksidenti teknikisht ka pasur mundësi të ndodhë si rezultat i përplasjes së automjetit “Opel Kadet” me automjetin transportues “Magirus” (...) i cili mendim është në lidhje me logjike me provat materiale si: raportet policore dhe skicën e vendit të ngjarjes, me deklaratat e pjesëmarrësve në aksident, si dhe me ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti A.A*...”.

[...]

35. Më 28 janar 2022, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktvendimit [Ae. nr. 190/2021] të Gjykatës së Apelit të 14 dhjetorit 2021 për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore; dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 182, paragrafi 2, pika n) e LPK-së nga Gjykata e Apelit.
36. Më 1 shtator 2022, Gjykata Supreme e Kosovës nëpërmjet Aktgjykimit [E. Rev. nr. 47/2022] e refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktvendimit [Ae. nr. 190/2021] të Gjykatës së Apelit të 14 dhjetorit 2021.
37. Gjykata Supreme e Kosovës, në arsyetimin e Aktgjykimit [E. Rev. nr. 47/2022], ndër të tjerash kishte theksuar se :

“Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, kanë marrë vendime të ndryshme sa i përket zbatimit të së drejtës materiale. Gjykata e shkallës së parë nuk e ka zbatuar të drejtën materiale sepse nuk ka shqyrtuar provat shkresore dhe konstatimet kundërtënëse duke mos dhënë fare arsye pse nuk është pranuar konstatimi i ekspertit individual, raporti i policisë nga vendi i ngjarjes dhe versioni i parë nga grupi i ekspertëve, të gjitha e nxjerrin shkaktare të aksidentit të siguruarën e të paditurës. Për këto shkaqe, Gjykata Supreme gjeti se Gjykata e Apelit me të drejtë ka konstatuar se janë plotësuar kushtet që e paditura të obligohet që paditëses t’ia kompensoi dëmin real në bazë të nenit 154 të LMD-së si dhe fitimin e munguar për një periudhë të arsyeshme kohore prej 30 ditësh si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.”

[...]

“Pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykata e shkallës së dytë i është përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së dytë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë dhe përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare.”

[...]

Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë kur konstaton se gjykata e shkallës së parë gjatë vendimmarrjes nuk i ka vlerësuar me kujdesin e duhur provat e lartcekura një nga një dhe të gjitha së bashku ashtu siç parashihet me nenin 8 të LPK-së (...) Përfundimisht Gjykata Supreme e Kosovës e pranon qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë se gjendja e konstatuar faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë, nuk korrespondon me provat shkresore në dosje dhe si pasojë e kësaj nuk është zbatuar drejtë e drejta materiale....”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara më nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
39. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31, parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta “për një vendim të arsyetuar” me pretendimin se: *“ gjykata nuk i ka adresuar argumentet e të paditurës, Kompanisë së Sigurimeve Sigal. Neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës kërkojnë nga gjykatat që të japin përgjigje të hollësishme për çdo argument apo pyetje. Nëse një kërkesë është thelbësore për rezultatet e çështjes, atëherë gjykata duhet që në mënyrë specifike ta trajtojë atë në gjykim.”*
40. Sa më sipër, parashtruesi i kërkesës konkludon se Gjykata Supreme nuk ka arritur të sqarojë mjaftueshëm faktet e parashtruara në revizion, dhe këtë konstatim e mbështet edhe për gjykatat e tjera të rregullta duke theksuar se: *“ Gjykata Supreme e as gjykatat e instancave më të ulëta të ulëta, nuk kanë marrë për bazë Super ekspertizën mbi aksidentin e komunikacionit të përpiluar nga tre ekspertet e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike me lëndën C.nr.636/13, ku sipas ligjit të procedurës kontestimore LPK, konkretisht neni 358 alineja 4, ekspertizat e hartuara nga Fakulteti kanë fuqi të madhe provuese (...) pasi që Fakulteti ka institutin e licencuar dhe është i specializuar për superekspertiza nga lëmia e komunikacionit, pra nuk është çështje e gjykatës ta vlerësoj fuqinë e provave të cilat në mënyrë tekstative janë të përcaktuara me ligj.”*
41. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës potencon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme përmban të meta serioze dhe karakterizohet nga arsyetimet joadekuate, duke aluduar se e njëjta ka dështuar të arsyetoj besueshmërinë e refuzimit të pretendimeve të tij dhe se nuk i ka përmbushur parimet e përgjithshme mbi të drejtën e një vendimi të arsyetuar gjyqësor të paraparë me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.
42. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 24, parashtruesi i kërkesës thekson se: *“Çdokush që është palë në proces të drejtë gjyqësor duhet të ketë mundësi të barabartë që të paraqesë çështjen e vet dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit.”*
43. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që ta deklarojë kërkesën të pranueshme, të konstatojë shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, që ta shpallë të pavlefshëm aktgjykimin [E. Rev. nr. 47/22], dhe ta kthejë çështjen në rigjykim.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

Neni 31
[E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.
- [...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6.1
(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

1. “Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.
- [...]

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 8

“8.1 Se cilat fakte do t'i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit.

8.2 Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon ç'do provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku.”

Neni 182

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

[...]

n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;

Neni 214

“214.2 Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.”

Neni 215

Gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur vetëm në pjesën e tij të goditur me anë të revizionit dhe vetëm brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt;

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

44. Gjykata fillimisht shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
45. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

46. Gjykata i referohet edhe paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*
47. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të dorëzojë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës [KI41/09](#), parashtrues [Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.](#), Aktvendim për Papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
48. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

49. Përkitazi me përmbushjen e kritereve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: i. është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ii. ai konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [E. Rev. 47/2022] të Gjykatës Supreme, të 1 shtatorit 2022; iii. ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; iv. ka specifikuar qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe v. kërkesën e ka dorëzuar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç përcakton neni 49 i Ligjit.
50. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton se:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
51. Gjykata së pari thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
52. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura ose të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuzë dhe të paqarta” (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Kemmachev kundër Francës](#), kërkesa nr. [17621/01](#), kategoria (i), [Mentzen kundër Letonisë](#), kërkesa nr. [71074/01](#), kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), kërkesa nr. [4241/03](#), kategoria (iii)).
53. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53

[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

54. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata rikujton se thelbi i kërkesës ndërlidhet me procedurën në të cilën gjykatat e rregullta përcaktuan se e kujt është përgjegjësia në lidhje me aksidentin e komunikacionit në të cilin ishte përfshirë vetura e siguruar te parashtruesi i kërkesës dhe për rrjedhojë është përgjegjësia e tij në aspektin e kompensimit monetar për dëmin që ka ndodhur si rezultat i atij aksidenti të komunikacionit.
55. Çështja pranë gjykatave të rregullta u mbyll në atë mënyrë që Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme konkluduan se aksidenti i trafikut kishte ardhur si rezultat i fajit të ngasësit të veturës që ishte siguruar te parashtruesi i kërkesës. Parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me këtë përfundim, sepse konsideron se gjykatat e rregullta në vendimet e tyre nuk kanë dhënë shpjegim për argumentet e tij qenësore ankimore. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës vlerëson se ka pasur shkelje të neneve 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ku kërkohet që gjykatat të japin përgjigje të hollësishme për çdo argument ose çështje nëse një kërkesë është e një rëndësie thelbësore për rezultatin e çështjes”.
56. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës i sjell shkeljet e neneve 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me mangësitë serioze të aktgjykimeve për sa i përket arsytimit të tyre lidhur me çështjen e “*Super ekspertizës mbi aksidentin e komunikacionit të përpiluar nga tre ekspertët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike*”. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata do të shqyrtojë në vazhdim të aktvendimit nëse arsyetimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme plotësojnë kriteret e vendimeve të arsyetuara gjyqësore në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
57. Bazuar në sa më sipër, Gjykata thekson se e drejta për një vendim të arsyetuar është pjesë e pandashme e së drejtës për një gjykim të drejtë, e cila i detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, sepse mungesa e arsyeve të mjaftueshme dhe relevante në vendimin e gjykatës mund të tregojë, ndër gjëra të tjera, vendimmarrje arbitrare gjyqësore. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se gjykatat janë të detyruara t'i përgjigjen në mënyrë të detajuar çdo argumenti të paraqitur nga palët në procedurë, përkatësisht në ankesa ose parashtresa të tjera përkatëse, por duhet t'u përgjigjen atyre argumenteve që janë kyçe dhe vendimtare për marrjen e një vendimi (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së, [Ajdarić kundër Kroacisë](#), të 13 dhjetorit 2011, numri i kërkesës 20883/09, pika 34).
58. Gjykata rikujton se përkundër faktit që gjykata e brendshme ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmimeve, ajo është e detyruar të justifikojë veprimet e saj duke arsyetuar të gjitha vendimet e saj (shih, rastet e GJEDNJ-së: [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe rastin [Carmel Saliba kundër Maltës](#), nr. 24221/13, aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).
59. Gjykata gjithashtu rikujton se neni 6 paragrafi 1 i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por nuk mund të interpretohet në kuptimin që kërkon që gjykata të japë një përgjigje shteruese për çdo argument të paraqitur (shih rastin e GJEDNJ-së, [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 29 janarit 1990, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).

60. Megjithatë, nëse parashtrësja e një pale është vendimtare për rezultatin e procedurës, ajo kërkon që t'i përgjigjet në mënyrë specifike dhe pa vonesë (shih rastet e GJEDNJ-së, Ruiz Torija kundër Spanjës, cituar më lart, paragrafi 30; Hiro Balani kundër Spanje, cituar më lart, paragrafi 28).
61. Prandaj, gjykatat e brendshme janë të obliguara që të shqyrtojnë, ndër të tjera, argumentet kryesore të palëve (shih rastet e GJEDNJ-së, Buzescu kundër Rumanisë, nr. 61302/00, aktgjykim i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; Donadze kundër Gjeorgjisë, nr. 74644/01, aktgjykim i 07 qershorit 2006, paragrafi 35).
62. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata konstaton se në procedurën në Gjykatën Themelore, çështja e super-ekspertizës e kërkuar nga parashtruesi i kërkesës ishte prova më e rëndësishme që ndikoi në rezultatin e procedurës. Më konkretisht, gjatë përcaktimit të përgjegjësisë për aksidentin e komunikacionit, Gjykata Themelore ia fali besimin më shumë versionit të dytë të super-ekspertizës, sipas së cilës përgjegjësia për aksidentin e komunikacionit i ngarkohet paditësit.
63. Megjithatë, Gjykata e Apelit, në aktgjykimin e saj, me arsyetimin e të cilit nuk pajtohet parashtruesi i kërkesës, arsyetoi në tërësi çështjen e super-ekspertizës, me ç'rast e klasifikoi atë në fushën e materialit dëshmues. Më konkretisht, Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit konkludoi se vlerësimi i super-ekspertizës si bazë për nxjerrjen e aktgjykimit për përgjegjësinë e dikujt nuk është i mjaftueshëm, duke marrë parasysh nenin 8 paragrafi 2 të LPK-së, i cili vendos disa standarde gjatë vlerësimit të provave. Rrjedhimisht, sipas mendimit të Gjykatës, para se të nxirrte një konkluzion në lidhje me përgjegjësinë, Gjykata Themelore duhej të merrte parasysh jo vetëm mendimin e dytë nga super-ekspertiza, por edhe provat e tjera dëshmuese që ishin në shkresat e lëndës, për të vlerësuar kështu të gjitha provat individualisht, pastaj të gjitha së bashku, që është pikërisht në pajtim me dispozitën e lartpërmendur ligjore të nenit 8, paragrafi 2 të LPK-së.
64. Përveç kësaj, Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit gjen edhe një pjesë në të cilën trajtohet konkretisht vlerësimi i super-ekspertizës si pjesë e provave nga materiali dëshmues, ku në asnjë moment nuk mohon ekzistimin e mundësisë që edhe versioni i dytë i ndodhjes së aksidentit të komunikacionit të jetë i saktë. Megjithatë, ajo që Gjykata e konsideron si një fakt të rëndësishëm që ndikon në rezultatin e procedurës sa i përket çështjes së përgjegjësisë është konkluzioni i Gjykatës së Apelit, se *“grupi i ekspertëve mendimin e tyre e bazojnë ekskluzivisht në supozime, ku edhe vet ekspertët në faqen 8 të ekspertizës e konstatojnë një gjë të tillë, ndërsa gjykata e shkallës së parë nuk je parsye për mos faljen e besimit provave tjera materiale, si dhe mendimit të grupit të ekspertëve të shprehur si në variantin I, të cilët kanë konstatuar se aksidenti teknikisht ka pasur mundësi të ndodhë si rezultat i përplasjes së automjetit “Opel Kadet” me automjetin transportues “Magirus” (...) i cili mendim është në lidhje me logjike me provat materiale si: raportet policore dhe skicën e vendit të ngjarjes, me deklaratat e pjesëmarrësve në aksident, si dhe me ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti A.A*...”*.
65. Në pajtim me konkluzionin e Gjykatës Themelore ekspertët në raportin e tyre nuk kanë përjashtuar me siguri mundësinë që aksidenti ka ndodhur në mënyrën e përshkruar në raportin e policisë që është bërë në momentin e ndodhjes së tij. Në këtë mënyrë, super-ekspertiza i jep mundësinë gjykatës të vlerësojë dhe të nxjerrë një përfundim në korrelacion me provat e tjera nga materiali dëshmues, se cili version i super-ekspertizës është më real në lidhje me përgjegjësinë.
66. Për më tepër, Gjykata nuk mund të mos vërë re pjesën e arsyetimit në aktgjykim, në të cilën Gjykata e Apelit i fali më shumë besim raportit të policisë si dhe versionit të parë

të super-ekspertizës, për të cilën, sipas mendimit të kësaj gjykate, ka dhënë argumente të vlefshme, të cilat i mbështetë edhe kjo gjykatë. Në mbështetje të kësaj, Gjykata e Apelit arriti në përfundimin se; **a)** versioni i dytë i ekspertizës nuk bazohet në provat e siguruara menjëherë pas ndodhjes së rastit, **b)** grupi i ekspertëve e mbështeti mendimin e tij, si dhe mbështetë versionin e dytë, ekskluzivisht në supozime, ku vetë ekspertët në faqen e 8-të të ekspertizës kishin konstatuar diçka të tillë, **c)** gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsyetim lidhur me mosfaljen e besimit në provat e tjera materiale dhe mendimin e grupit të ekspertëve të shprehur si në versionin e parë, **d)** provat materiale siç janë: raportet e policisë dhe një skicë nga vendi i ngjarjes, deklaratat e pjesëmarrësve në aksident, si dhe ekspertiza rrugore e përpiluar nga eksperti A. A., janë dëshmi që vërtetojnë bindshëm faktin vendimtar se aksidenti ka ndodhur për fajin e të siguruarit të të paditurës.

67. Gjykata konstaton se është pikërisht qëndrimi i Gjykatës së Apelit për sa i përket përgjegjësisë që ajo e ka arsyetuar në aktgjykimin e kontestuar dhe në përputhje me nenin 8, paragrafi 2 të LPK-së, sipas të cilit Gjykata duhet të marrë pretendime të caktuara si të vërtetuara, vetëm pasi të jetë bindur për saktësinë e tyre në bazë të provave të përdorura dhe të vlerësuara nga i gjithë materialit dëshmuar.
68. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata, përkundër pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk është i arsyetuar përkitazi me çështjen e “*argumentit më të rëndësishëm*”, është i pabazuar por se si i tillë ai përmbush plotësisht kriteret e garantuara. me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
69. Më tej, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se edhe aktgjykimin të Gjykatës Supreme i mungon një arsyetim adekuat në lidhje me çështjen e vlerësimit të super-ekspertizës, Gjykata vëren se Gjykata Supreme i pranoi në tërësi konkluzionet e Gjykatës së Apelit pikërisht në lidhje me vlerësimin, si të versionit të parë po ashtu edhe të versionit të dytë të super-ekspertizës që është bërë me kërkesë të parashtruesit të kërkesës. Në lidhje me këtë, Gjykata vë në dukje se arsyetimi standard i një vendimi gjyqësor si një segment i së drejtës për një gjykim të drejtë u mundëson gjykatave më të larta që thjesht të mbështesin arsyet e dhëna nga gjykatat më të ulëta si arsyetime, pa qenë nevoja të përsëriten ato arsye (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, 21 janar 1999, paragrafi 26, dhe *Kikabidze kundër Gjeorgjisë, Gruzije*, aktgjykim i 16 shkurtit 2022, paragrafi 62), nëse nga rrethanat e rastit konkret nuk rezulton se gjykata e shkallës më të lartë nuk është marrë me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, përkatësisht nuk ka pranuar thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Talmane kundër Letonisë* ë, të 13 tetorit 2016, pika 31).
70. Gjykata vëren se, në kundërshtim me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj u është përgjigjur të gjitha kundërshtimeve ankimore që ajo i konsideronte thelbësore dhe relevante për të vendosur për meritat e kërkesës, përkatësisht përgjegjësinë, dhe ajo dha arsye të vlefshme, të qarta dhe logjike për qëndrimin e saj në përputhje me kërkesën e nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së.
71. Në mbështetje të këtij përfundimi të Gjykatës qëndron edhe fakti se Gjykata Supreme, sipas pretendimeve ankimore të parashtruesit të kërkesës se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk është në pajtim me nenin 182, paragrafi 2, pika n) të LPK-së, ishte e mendimit se dispozitivi i aktgjykimin të Gjykatës së Apelit është në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë dhe se ai përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, duke përfshirë edhe shkeljet për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare. Gjykata Supreme ishte gjithashtu e mendimit se Gjykata e Apelit dha arsyetime të mjaftueshme dhe bindëse për mënyrën e vendimmarrjes meritore lidhur me çështjen e përgjegjësisë për shkaktimin e

- aksidentit të trafikut, si dhe për çështjen e vlerësimit të super-ekspertizës si pjesë e materialit dëshmuës.
72. Prandaj, Gjykata vlerëson se edhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme në lidhje me arsyetimin e *“argumenteve thelbësore të parashtruesit të kërkesës”* është plotësisht në pajtim me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe rrjedhimisht Gjykata i konsideron të pabazuara këto pretendime të parashtruesit të kërkesës.
 73. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës e shpjegon shkeljen e këtij neni me pretendimin se, *“Çdokush që është palë në proces të drejtë gjyqësor duhet të ketë mundësi të barabartë që të paraqesë çështjen e vet dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit.”*
 74. Në mbështetje të kësaj, Gjykata thekson se neni 24 i Kushtetutës garanton barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit dhe përcakton të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë gjyqësore pa asnjë dallim ndërmjet tyre. Në të vërtetë, kuptimi i këtij neni është ndalimi kushtetues i diskriminimit, si parakusht themelor për sigurimin e respektimit të të gjitha të drejtave të tjera të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe realizimin e tyre në kushte të barabarta.
 75. Megjithatë, në një pjesë të pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës nuk ka dhënë argumente për ekzistencën e ndonjë forme të diskriminimit, ndërsa nga ana tjetër, Gjykata, duke shqyrtuar pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, vëren se gjatë tërë procedurës, parashtruesi i kërkesës ishte palë në një procedurë në të cilën ai kishte mundësi të barabarta të paraqes çështjen e tij para gjykatave kompetente.
 76. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se edhe ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është i pabazuar.
 77. Si përfundim, Gjykata konsideron se në procedurat pranë gjykatave të rregullta, nuk ka pasur shkelje të të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për të gjitha arsyet e lartpërmendura.
 78. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në tërësinë e saj, për arsye se pas analizës u konstatua se pretendimet e parashtruesit të kërkesës kualifikohen si pretendime që bëjnë pjesë në kategorinë (iii) e pretendimeve *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*, andaj këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
 79. Prandaj, kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme në baza kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113 (7) të Kushtetutës, parashikohet me nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 7 qershor 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka Nimani

